

AKTIVITETE PROMOVUESE NË BASHKITË E VOGLA



Fushë-Arrëz

Në kuadër të promovimit të Ndhmës Juridike Falas në çdo bashki, në datën 23.09.2024 në ambientet e Bashkisë Fushë Arrëz, u zhvillua takimi me prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndhmës Juridike Falas z.Ergys Qirici, si dhe me prezencën e Kryetarit z. Hilë Curri, Zv. Kryetarit z.Hikë Kolaj, zv.Kryetarit z.Mikel Qafa, si dhe përfaqësues nga institucione të ndryshme lokale. Prezent në takim ishin edhe QSHPNJ Shkodër z.Anton Koca dhe QSHPNJ Pukë z. Artur Murra.



Krujë

Në kuadër të promovimit të Ndhmës Juridike Falas në çdo bashki, në ambientet e Bashkisë Krujë, u zhvillua takimi me prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndhmës Juridike Falas z.Ergys Qirici, si dhe me prezencën e përfaqësuesve nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale të Bashkisë, punonjës të Ndhmës Sociale, Punonjëse e përmbarimit, punonjës të policisë Krujë, punonjës të shëndetësisë, si dhe punonjësit e QSHPNJ Durrës znj. Françeska Miraka dhe znj. Anxhela Mansi dhe QSHPNJ Kavajë z.Lauren Vogli.



Durrës

QSHNJP Durrës zhvilloi në datën 13.09.2024 një aktivitet informues dhe ndërgjegjësues në Njesinë Administrative nr.3 Durrës.

QSHNJP Durrës zhvilloi në datën 20.09.2024 një aktivitet me kategorinë e veçantë përfituese të ligjit "Persona me aftësi të kufizuara dhe individ me probleme të shëndetit mendor" në bashkëpunim me Shoqatën e Tetraplegjikëve.

QSHNJP Durrës zhvilloi në datën 24.09.2024, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të

garantuar nga shteti, një aktivitet "Street Law", në ambjentet e Kryqit Kuq Durrës.

QSHNJP Durrës zhvilloi në datën 26.09.2024 aktivitet informues në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Durrës e Formimit Profesional.



Tiranë

QSHNJP Tiranë, së bashku me specialisten e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas Zj. Sindi Prifti morrën pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Brendshme, me temë "Marrja e masave për organizimin e muajit antitrafik dhe angazhimi institucional për mbarëvajtjen e tyre".



Elbasan

QSHNJP Elbasan, në datën 19.09.2024 ka zhvilluar një "sesion informimi street low" me qytetarët në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi Ligjin 111/2017 " Për Ndhmën Juridike të garantuar nga shteti "



Fier

QSHNJP Fier, në datën 24.09.2024 mori pjesë në takim si anëtare e ETN pranë Bashkisë Roskovec. Qëllimi i takimit ishte diskutimi në bazë të kërkesës së bërë nga z. Festim Sufka shoqëruar nga gazetarët e emisionit Stop.



QSHNJP Fier, në datën 25.09.2024, mori pjesë në tryezën teknike të luftës kundër trafikimit të personave, organizuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier.

QSHNJP Fier, në datën 27.09.2024, zhvilloi një takim pranë Njesisë Administrative Kuman, Bashkia Roskovec, në bashkëpunim me Shërbimin Social Roskovec, në kuadër të bashkëpunimit institucional, promovimit dhe informimit mbi shërbimet ligjore falas.



Korçë

QSHNJP Korçë, në datën 18.09.2024 zhvilloi një takim informues në bashkëpunim me Znj. Etleva Tare përfaqësuese e Komisionerit për Mbrojtje ndaj Diskriminimit në qytetin e Korçës.

QSHNJP Korçë, në datën 19.09.2024 mori pjesë në takimin e organizuar bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social dhe qytetarë përfitues të Aftësisë së Kufizuar.



QSHNJP Korçë, në datën 19.09.2024 mori pjesë në takimin e realizuar nga Drejtoria e Kujdesit Social, mbledhja e Grupit Teknik Ndersektorial për rastin e dy femijëve të mitur A.Sejdaras dhe A.Sejdaras të cilët nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm.

QSHNJP Korçë, në datën 23.09.2024 mori pjesë në takimin e realizuar nga Prefekti i Qarkut Korçë në kuadër të zbatimit të Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër trafikimit të personave 2024-2025.

QSHNJP Korçë, mori pjesë pjesë në mbledhjen e grupit për shtetasen M.T e cila u dogj me benzinë nga bashkeshorti i saj shtetasi E.T. Në përfundim të takimit u evidentua se shtetasja M.T ka nevojë për ndihmë juridike detyësore për të hapur proces gjyqësor për zgjidhje martese dhe kujdestarinë e femijëve

Vlorë



QSHNJP Vlorë zhvilloi në datën 23.09.2024, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë një diskutimin të hapur me temë "Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në shërbimet publike", mbajtur midis përfaqësuesve më të lartë të pushtetit vendor dhe përfaqësuesve të tre shoqatave PAK.

QSHNJP Vlorë zhvilloi në datën 27.09.2024 aktivitetin "Street Law", me qytetarë të Vlorës, duke shpërndarë fletëpalosje. Takimi kishte për qëllim promovimin e shërbimeve të zyrës sonë, por edhe të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në tërësi.



Kurbin

QSHNJP Kurbin zhvilloi në datën 16.09.2024 ka organizuar një takim pranë Njesisë Administrative Fushë-Kuqe, me prezencën e administratorit të njësie z. K.Martinaj, si dhe Specialistë të Shërbimit Social Fushë-Kuqe.

QSHNJP Kurbin zhvilloi në datën 24.09.2024 një sesioni informues "street law" në kuadër të fushatës ndërgjegjëse, informuese dhe mbështetëse me komunitetin e Lagjes nr.2 në kodër Laç, Bashkia Kurbin.



Gjirokastrë

QSHNJP Gjirokastrë, në datën 27.09.2024, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk dëgjojnë (ANAD), me temë *"Enhancing Legal and Digital Literacy to Empower Marginalized Women and Men for Rights Advancement and Access to Justice in Albania"*.

Lezhë

QSHNJP Lezhë, në datën 12.09.2024, priti në ambientet e zyrës Zj. Ivana Zivkovic, Ndhmës Sekretaren e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, shoqëruar nga zj. Monica Merino, përfaqësuesja e Përhershme e UNDP në Shqipëri.



Kavajë

QSHNJP Kavajë, në datën 11.09.2024 zhvilloi një takim me fokus bashkëpunimin midis OJF "TLAS" dhe Qendrave të shërbimit.

QSHNJP Kavajë, në datën 19.09.2024 zhvilloi një takim promovues me Shërbimin Social Rogozhinë.

QSHNJP Kavajë, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues dhe promovues, në bashkëpunim me OJF "TLAS", me komunitetin ROM, në Kavajë.

QSHNJP Kavajë, në datën 25.09.2024, në bashkëpunim me shoqatën "TLAS" zhvilloi një takim ndërgjegjësues me institucionet vendore të Bashkisë Rogozhinë.



Përmet

QSHNJP Përmet zhvilloi në datën 16.09.2024 një takim informues në Njësinë Administrative Petran me administratorin e kësaj njësie Z.Ylli Dervishi dhe përfaqësues të tjerë të njësisë.



QSHNJP Përmet zhvilloi në datën 30.09.2024 një aktivitet informues me ambientet e Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor. Në këtë takim morën pjesë punonjëset e administratës si dhe infermieret.

Pukë

QSHNJP Pukë zhvilloi në datën 12.09.2024 në kuadër të zbatimit të kalendarit të aktiviteteve vjetore, një aktivitet "Street Law", për informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve në qytetin e Pukës.



Berat

QSHNJP Berat në datën 17.09.2024 mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me temë *"Ndarja e praktikave të mira të Austrisë dhe Shqipërisë në adresimin e Dhunës me Bazë Gjinore"*.

